



STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 12 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE BANKAT DHE AGJENCITE E HIPOTEKAVE DO TE PERSHPEJTOJNE PAGESAT E SIGURIMEVE PER PRONARET E SHTEPIVE

Masat do të eliminojnë burokracinë që parandalon pronarët e shtëpive nga marrja e fondeve të sigurimeve

Periudha e faljes së pagesave të hipotekave gjithashtu zgjatet me tre muaj të tjerë

Guvernatori Endrju M. Cuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se bankat dhe agjencitë kryesore të hipotekave do të ndërmarrin veprime për të përshpejtuar pagesat e sigurimeve për pronarët e shtëpive të Nju Jorkut (New York). Tashmë, çeqet e pretendimeve të sigurimeve duhet të miratohen nga bankat ose agjencitë e hipotekave përpara sesa pronarët e shtëpive të mund të marrin paratë për to, duke shkaktuar vonesa shqetësuese në një kohë kur paratë janë të nevojshme për riparime në shtëpi ose për shpenzime të jetesës. Këto veprime të reja do të lejojnë që ndërmarrjet e sigurimeve t'ua japin paratë më shpejt pronarëve të shtëpive.

Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) (DFS) ka marrë ankesa të shumta nga pronarët e shtëpive se agjencitë dhe bankat janë duke vendosur kërkesa të rrepta të pazakonta përpara sesa të nënshkruajnë çeqet. Kjo ka rezultuar në vonesa të papranueshme në dhënien e parave për banorët e Nju Jorkut (New York) në nevojë. Megjithatë, masat e reja do të lejojnë që pronarët e shtëpive të marrin paratë e tyre shpejt.

“Pronarët e shtëpive kanë nevojë për ndihmë tani dhe kjo është se pse siguresit janë duke dërguar çeqe paraprake për të përmbushur nevojat e menjëhershme të tyre,” tha Guvernatori Cuomo (Cuomo). “Çdo vonesë në bërjen e këtyre lloj riparimeve vendimtare në shtëpi mund të nënkuptojë ndryshimin ndërmjet një familje të qenit në gjendje që të jetojë me siguri në shtëpinë e tyre ose të qëndrojnë pa nevojshëm të zhvendosur për disa javë ose edhe muaj. Dëshiroj të falënderoj këto banka dhe agjencitë e hipotekave për partneritetin me ne dhe u bëj thirrje bankave dhe agjencive të tjera që të përmbushin standartin e vendosur nga konkurrentët e tyre.”

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawskey), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare, tha, “Pagesat e sigurimeve janë një pjesë thelbësore kur njerëzit rindërtojnë jetën e tyre. Do të vazhdojmë të bëjmë gjithashka që mundemi për të parë se pretendimet përpunohen në kohë dhe pronarët e shtëpive dhe binzeset marrin të gjitha fondet që u takojnë në mënyrë që të rimëkëmben. Është mirë të shohim këto banka dhe agjenci që përgjigjen dhe do të përpiqen të shpejtojnë rimëkëmben e Shtetit tonë.”

Guvernatori gjithashtu njoftoi sot se periudha e faljes së pagesave të hipotekave është zgjatur për tre muaj të tjerë. Kjo kohë shtesë do t’u lejojë banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) të prekur nga Uragani Sendi (Sandy) që të bëjnë të gjitha pagesat e tyre pa u dashur që të përballen me agjencitë e mbledhjes së borxheve ose një rezultat të ulët të kredisë.

Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) (DFS) ka marrë ankesa të shumta nga pronarët e shtëpive se agjencitë dhe bankat janë duke vendosur kërkesa të rrepta të pazakonta përpara sesa të nënshkruajnë çeqet paraprake, me rezultatin se kanë qënë të ngadaltë pa arsye në dhënien e parave. Kjo është duke shkaktuar probleme të rënda për shumë familje që kanë nevojë mjaft të madhe për paratë e tyre të sigurimeve që të jetojnë dhe të fillojnë të bëjnë riparime. Masat e njoftuara sot do të lejojnë që më shumë pronarë të shtëpive të marrin paratë paraprake të tyre në kohë.

Bankat dhe agjencitë pjesëmarrëse janë:

- Bank of America
- Citi Mortgage
- JPMorgan Chase N.A.
- Wells Fargo Home Mortgage
- Apple Savings Bank
- Dime Savings Bank of Williamsburg
- Emigrant Savings Bank
- Homeward Residential
- M&T Bank, Nationstar
- New York Community Bank
- Ocwen Loan Servicing

Bankat dhe agjencitë kërkohen të ndjekin rregulla të ndryshme të vendosura nga Fannie Mae, Freddie Mac dhe investitorët që zotërojnë letrat me vlerë të mbështetura nga hipotekat. Në përgjithësi, si rezultat i diskutimeve me administratën Kuomo (Cuomo), institucionet janë duke ofruar llojet e ndryshme të ndihmës:

- Bankat dhe agjencitë tani do të përdorin sa më shumë autoritet që kanë sipas rregullave për të

transferuar menjëherë fondet për riparime të shtëpive tek pronarët e shtëpive dhe kontraktorët e tyre.

- Bankat dhe agjencitë do të japin menjëherë çdo pjesë të fondeve të sigurimeve ose të ndihmës të caktuar për shpenzime të jetesës ose zëvendësimin e pasurisë personale dhe do të japin menjëherë çdo fond që kapërcen balancën e papaguar të huasë.
- Nëse sasitë e shpenzimeve të jetesës dhe pasurisë personale nuk janë identifikuar një e nga një në pagesën e sigurimeve ose të ndihmës, bankat dhe agjencitë do të kërkojnë që siguruesi të paraqesë një listë dhe do të japin menjëherë fondet e caktuara.
- Bankat dhe agjencitë nuk do të përdorin ndonjë pjesë të një çeku të sigurimeve ose të ndihmës për pagesat e prapambetura të hipotekës pa pëlqimin ose të pronarit të shtëpisë ose një sipërmarrje të financuar nga qeveria federale si Fannie Mae ose Freddie Mac.

Detajet mund të ndryshojnë nga institucioni në institucion dhe u nënshtrohen kërkesave të investitorëve dhe rregullatore. Huamarrësit duhet të kontaktojnë bankat ose agjencitë e hipotekave të tyre individuale për hollësi.

Përveç kësaj, disa banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) po vënë re se periudha tre-mujore e faljes së pagesave të hipotekave e ofruar më pare nga bankat dhe agjencitë e hipotekave nuk është e mjaftueshme për t'u rimëkëmbur. Me kërkesë të administratës Kuomo (Cuomo), bankat dhe agjencitë do t'a zgjasin këtë periudhë për deri në tre muaj të tjerë, për gjithsej gjashtë muaj pas stuhisë për llojet e mëposhtme të ndihmës:

- Shtyrje të rimarrjeve dhe dëbimeve.
- Heqje të pagesave të vonesave për pagesat e hipotekës.
- Në disa raste, mbështetur në faktet dhe rrethanat e caktuara të huamarrësit, shtyrje të pagesave të hipotekave kur huamarrësi është prekur nga stuhia dhe kërkon ndihmë.

Detajet mund të ndryshojnë në institucione të ndryshme dhe u nënshtrohen udhëzimeve të investitorëve, kështu që pronarët e shtëpive duhet të pyesin mbajtësin e hipotekës së tyre. Në fund të periudhës së faljes, bankat dhe agjencitë do të vendosin një plan të pagesave për të lejuar që pronarët e shtëpive të ripaguajnë pagesat e vonuara të tyre gjatë një periudhe të zgjatur kohe.

“Përgëzojmë Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe Kryeinspektorin Loski (Lawsy) për kryesimin e punës me industrinë bankare në këtë çështje të rëndësishme dhe jemi të kënaqur të punojmë me

Guvernatorin në vazhdimin e ndihmës për pronarët e shtëpive gjatë kësaj kohe të vështirë,” tha Sanxhiv Das (Sanjiv Das), President dhe CEO i CitiMortgage.

Xhosh Ziner (Josh Zinner), Bashkë-Drejtor i NEDAP, një organizatë e drejtësisë ekonomike me qendër në Qytetin e Nju Jorkut (New York City), tha, “NEDAP përgëzon Administratën Kuomo (Cuomo) për punën për të siguruar se agjencitë e hipotekave nuk ndërhyjnë në pagesën e plotë dhe të shpejtë të të ardhurave nga sigurimet për pronarët e shtëpive të prekur nga stuhia. Shpresojmë se çdo agjenci e hipotekave që bën biznes në shtet do të marrë të gjitha masat e mundshme për të shmangur rimarrjet dhe për të ndihmuar që komunitetet e goditura rëndë nga stuhia të rindërtohen.”

Margaret Beker, Bashkë-drejtoreshë, Projekti i Mbrojtjes së Pronarit të Shtëpisë (Homeowner Defense Project), Shërbimet Ligjore të Stejtën Ajlënd (Staten Island Legal Services), “Shpirti dhe qëndrueshmëria e pronarëve të shtëpive përgjatë vijës bregdetare të Stejtën Ajlënd (Staten Island) të copëtuar nga stuhia është mahnitëse, por ata janë të lodhur. Puna e rëndë fizike ka pasoja, por po ashtu ka edhe burokracia. Ndihma e Departamentit dhe përkushtimi i bankave që fondet e sigurimeve të jepen shpejt dhe t’u jepet pronarëve të shtëpive fleksibilitet në pagesat e tyre të hipotekave do të ndihmojë në heqjen e një pjese të barrës për këta njerëz ndërsa ngadalë rindërtojnë jetën e tyre.”

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418